



Buletin Informativ

Data: 5 Prill 2018

Aktivitetet e muajit mars 2018

Aktivitetet kryesore:

- Takimi i Grupit të Përbashkët të Punës së Programit
- Finalizimi i analizës së detajuar për DVP Elbasan dhe dorëzimi i saj për aprovim
- Ceremonia e dorëzimit të biçikletave dhe aksesorëve për NSPK-të në Komisariatin e Elbasanit
- Zhvillimi i 5 koncepteve të trajnimit
- Shpallja e thirrjes së dytë për aplikime në kuadër të Skemës së Granteve dhe Vizita monitoruese për aktivitetet e tyre
- Takime me autoritetet lokale të Elbasanit në kuadër të rivitalizimit të KVSP dhe hartimi i rregullores së tyre

Takimi i Grupit të Përbashkët të Punës së Programit



Më 28 Mars 2018 u organizua takimi i radhës i Grupit të Përbashkët të Punës së Programit (GPP), me pjesëmarrës anëtarë nga departamentet kryesore të DPPSH-së. Takimi u bashkë-kryesua nga Drejtori i Departamentit të Sigurisë Publike Z. Gjovalin Loka dhe Drejtuesi i EMP-së SCPA. Në takim u prezantuan aktivitetet e kryera në 3 komponentët në bashkëpunim me PSH-në gjate periudhës mes 2 takimeve, si dhe u prezantua plani i punës për periudhën në vazhdim. GPP aprovoi planin e trajnimeve si dhe vendosi që PSH do të dërgojë listën me nevojat e domosdoshme për mbështetje logjistike.

Finalizimi i analizës së detajuar për DVP Elbasan, mbështetje për strukturën organizative dhe përshkrimet e punës

Grupi Teknik për kryerjen e një studimi të detajuar mbi funksionimin dhe organizimin e DVP Elbasan finalizoi dokumentin e analizës dhe e miratoi atë. Raporti u paraqit në formën përfundimtare në GPP, ku edhe u aprovua.

Në bashkëpunim me kolegët e DVP Pilot Elbasan, janë hartuar 10 përshkrime funksionale të punës për sektorët dhe seksionet e përfshira në strukturë, si edhe janë hartuar 12 përshkrimeve të punës për pozicionet kryesore.

Po në kuadër të mbështetjes së DVP pilot Elbasan, EMP ka asistuar në hartimin, dizajnimin dhe printimin e buletinit informativ të DVP Elbasan. Ky buletin u shpërnda në të gjithë personelin e DVP Elbasan duke përfshirë komisaritet dhe stacionet e policisë dhe kjo risi u prit shumë mirë. Qëllimi i buletinit është 1. Informimi i punonjësve të DVP Elbasan për ndryshimet e parashikuara për këtë DVP dhe 2. Informimi i DVP të tjera për ndryshimet e ndodhura në Elbasan dhe shpërndarjen e praktikave të mira.

Organizimi i ceremonisë së dorëzimit të biçikletave dhe aksesorëve për NSPK-të në Komisariatin e Elbasanit



Më 13 Mars 2018, në kuadër të riorganizimit të DVP Elbasan dhe krijimit të zonave policore, Programi SCPA organizoi një ceremoni me rastin e dorëzimit të 5 biçikletave së bashku me aksesorët e tjerë. Biçikletat janë destinuar për përdorim nga specialistët e policimit në komunitet në zonat e reja policore në qytetin e Elbasanit.



Gjithashtu, u vizituan dhe ambientet e reja të një zyre për punonjësit e policisë së zonës (NSPK) pranë njësisë administrative 4 në qytetin e Elbasanit. Bashkia Elbasan ka vënë në dispozicion të DVP Elbasan ambiente zyrash pranë secilës Njësi Administrative.

Në ceremoni ishte e pranishme dhe Zv/Ministrja e MB Znj. Romina Kuko e cila mbajti dhe fjalën e rastit.

Zhvillimi i 5 koncepteve të trajnimit

Ekipi i ekspertëve të programit SCPA ka zhvilluar planet e trajnimit për 5 njësi organizative në kuadër DVP së ristrukturuar. Këto plane parashikojnë të trajnojnë punonjës policie që nga Sektorët/seksionet e rinj që do të krijohen, deri tek patrullat dhe NSPK-të, duke i kushtuar vëmendje të veçantë trajnimit të trajnerëve nga radhët e PSH-së dhe akademisë së sigurisë. Programet e trajnimit janë:

1. Plani i trajnimit për analistin e Sektorit për Menaxhimin Strategjik, Planifikimin, Monitorimin dhe Vlerësimin në DVP-së;
2. Plani i Trajnimit për Oficerin e Policimit në Komunitet (NSPK);
3. Plani i Trajnimit për Oficerët e Patrullës së Përgjithshme dhe Oficerët e Qarkullimit Rrugor;
4. Plani i Trajnimit për personelin e Sektorit të Komandës dhe Kontrollit;
5. Plani i Trajnimit për zëdhënësin e shtypit dhe ekspertin e medias

Shpallja e thirrjes së dytë për aplikime në kuadër të Skemës së Granteve & Vizita monitoruese për aktivitetet e tyre



Në kuadër të skemës së granteve, EMP ka monitoruar aktivitetet e aplikantëve fitues. Janë kryer vizita në terren në Qarqet e Durrësit, Fierit dhe Shkodrës. Puna e kryer deri më tani është në përputhje me planet kohore. Gjithashtu EMP përgatiti dhe shpalli thirrjen e dytë për aplikime për grante e cila në këtë raund do të mbulojë qarqet Elbasan, Kukës, Tiranë dhe Gjirokastrë.

Takime me autoritet lokale të Elbasanit në kuadër të rivitalizimit të KVSP dhe rishikimi i rregullores

Në vijim të takimeve destinuar rigjallërimit të këshillave vendore të sigurisë publike (KVSP-së) Elbasan, EMP ka organizuar një sërë takimesh, ku është diskutuar me drejtorin e DVP-së dhe Kryetarin e Bashkisë Elbasan për të organizuar takimin e radhës së këtij forumi, i cili do të mbahet në javën e parë të muajit prill. Një draft rregullore e rishikuar është ndarë me aktorët e përfshirë dhe pritet të diskutohet/miratohet në mbledhjen e ardhshme. Programi parashikon një mbështetje të vazhdueshme për ta ngritur funksionin e Këshillit në rolin e parashikuar dhe për të përmirësuar bashkëpunimin mes gjithë aktorëve në nivel vendor. Pas Elbasanit, mbështetja është parashikuar të shtrihet në Librazhd dhe Cërrik dhe më pas edhe në qytete të tjera.

Na kontaktoni:

www.cp-project.al

info@cp-project.al